



ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS
KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LEKARSKA KOMORA KOSOVA

RAPORT VJETOR 2019

Oda e Mjekëve të Kosovës



Shkurt 2020

Prishtinë

Përmbajtja:

RAPORT VJETOR 2019	1
1. Infrastruktura Juridike.....	3
2. Këshilli Drejtues	4
3. Anëtarësimi.....	5
4. Mbikëqyrja etiko-profesionale.....	6
5. Edukimi i Vazhdueshëm Profesional.....	7
6. Licencimet	8
7. Edukimi specialistik-zbërthimi i kompetencës bazuar në Ligjin për Shëndetësi dhe Ligjin për OPSH-të.....	8
8. Komisioni për Çështje Etike i OMK-së.....	8
9. Komisioni për Solidaritet dhe Ndihmë Reciproke i OMK-së.....	9
10. Raporti Financiar	9
10.1 Gjendja financiare – 31 dhjetor 2019.....	9
10.2 Përkrahje për Edukim të Vazhdueshëm Profesional.....	10
10.3 Prokurimi	11
11. Aktivitete të tjera	11
11.1 Shërbimi profesional.....	11
11.2 Kongresi dhe Panairi i Parë i Mjekësisë	12
11.3 Punëtorja “Ditët ndërkombëtare të menaxhimit të rrugëve të frymëmarrjes”	13
11.4 Simpoziumi i parë Mbarëshqiptar i Kirurgjisë Pediatrike	14
11.5 Marrëveshjet	14
11.6 Faksimilët.....	15
11.7 Bashkëpunimi profesional dhe veprimtaria ekspertike.....	16
11.8 Punëtori për Sistemin e informimit të OMK-së.....	16
11.9 Auditimi financiar dhe funksional	17
11.10 Marrëdhënie ndërkombëtare	17
12. Plani i veprimit për 2020	17
Projektet afatmesme dhe afatgjata.....	17

1. Infrastruktura Juridike

Me datë 7 dhe 8 nëntor 2019 u organizua tryeza e rrumbullakët me temë Plan Veprimi i Odës së Mjekëve të Kosovës 2020, ku morrën pjesë të gjithë anëtarët e këshilleve dhe komisioneve të odës. Prezantimi i punës deri në periudhën nëntor 2019 u bë nga kryetarët e këshilleve dhe komisioneve, ku më pas u diskutuan dhe identifikuan sfidat dhe problemet në proceset e ndryshme të funksionimit të organeve të odës. Qëllimi i kësaj tryeze të rrumbullakët ishte finalizimi i Draft planit të punës 2020, Draft Buxhetit 2020 dhe propozimi për plotësim ndryshimet e amendamenteve të rregulloreve që do të shqyrtohen në mbledhjen e ardhshme të Kuvendit të OMK-së.

Kuvendi i Odës së Mjekëve të Kosovës gjatë vitit 2019 ka mbajtur dy mbledhje të rregullta ku janë shqyrtuar propozim amandamentet e akteve juridike të Odës. Në mbledhjen e mbajtur me datë 17 janar 2019 u miratuan plotësim ndryshimet e akteve normative të miratuara në mbledhjen e rregullt të kuvendit të mbajtur në qershor 2018, dhe po ashtu u miratua Rregullorja për Procedurat e Prokurimit dhe Rregullorja për Udhëtime Zyrtare, kurse Këshilli Drejtues i OMK-së miratoi Rregulloren për Sistematizimin e Vendeve të Punës në OMK.

Në kuadër të këtyre takimeve u miratuan rregulloret, manualët dhe amandamentet për plotësim ndryshim të akteve normative si në vijim:

- Amendamentet për Plotësimin dhe Ndryshimin e Kodit të Etikës dhe Deontologjisë Mjekësore;
- Amendamentet për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullorës për Regjistrimin, Licencimin dhe Rilicencimin e Mjekëve;
- Amendamentet për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullorës për Edukimin e Vazhdueshëm Profesional;
- Amendamentet për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullorës për Përcaktimin e Llojeve të Shkeljeve Etike dhe Procedurat e Mbikëqyrjes Etike;
- Amendamentet për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullorës së Punës të Këshillit Mbikqyrës të OMK-së;
- Amendamentet për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullorës për Menaxhimin e Financave të OMK-së;
- Amendamentet për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullorës së Punës së Komisionit për Solidaritet dhe Ndihmë Reciproke;

- Amendamentet për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullorës për Procedurat e Prokurimit në OMK;
- Rregullorja për Sistematizimin e Vendeve të Punës në OMK.
- Manuali për politika dhe procedura
- Manuali për politika dhe procedura të kontabilitetit të OMK-së
- Rregullore për përgjegjësinë disiplinore të shërbimit profesional
- Rregullore e brendshme për kodin e mirësjelljes në shërbimi profesional të OMK-se
- Rregullore e brendshme për pushimet e nënpunësve të shërbimit profesional të OMK-së

Ku ndër të tjera është amandamentuar Neni 24 i Rregullorës për Regjistrimin, Licencimin dhe Rilicencimin e Mjekëve, i cili parasheh përmbajtjen e faksimilit. Në këtë rast Kuvendi ka aprovuar që në faksimil të shtohen edhe gradat shkencore dhe thirrjet akademike për ata që posedojnë atë.

Gjithashtu, OMK në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë ka ndërmarrë iniciativën për hartimin e Rregullores për Menaxhimin dhe Mirëmbajtjen e Regjistrit të Institucioneve Shëndetësore në Republikën e Kosovës.

2. Këshilli Drejtues

Në vitin 2019, Këshilli Drejtues i OMK-së ka mbajtur 16 takime, ku janë pranuar 66 lëndë, nga të cilat janë marr 45 vendime sipas kërkesave/ankesave të pranuar dhe 20 lëndë janë në procedurë të cilat përfshijnë kërkesa/ankesa dhe njoftime.

Sfidat apo vështirësitë të cilat e kanë përcjellë Këshillin Drejtues të OMK-së gjatë vitit 2019 janë:

- Marrëveshje për Sigurimet të përgjegjësisë profesionale
- Bartja e kompetencës për edukimin specialistik
- Organizimi i Kongresit dhe Panairit të parë Mjekësor
- Auditimi financiar dhe funksional
- Përkrahje për pesë punimet shkencore më të mira të publikuara përgjatë vitit 2018 dhe 2019
- Botimi i librit “Enciklopedisa e doktorëve të shkencave të mjekësisë shqiptare gjithandej globit (1445-2019) dhe mjekëve që kanë lënë gjurmë të pashlyera në historinë e mjekësisë shqiptare”

3. Anëtarësimi

Anëtarësimi në Odën e Mjekëve të Kosovës ka filluar më datë 23 janar 2018. Gjatë vitit 2019 janë anëtarësuar 672 mjekë, si rezultat numri total ka arritur në 4244 mjekë, ku 3302 mjekë janë të punësuar në sektorin publik, 443 mjekë në sektorin privat, 473 mjekë të papunë dhe 26 mjekë pensionist.




Tabela 1 Anëtarësimi deri 31 dhjetor 2019




Tabela 2. Anëtarët e ndarë sipas moshës

Bazuar në tabelën më lartë shihet se moshë mesatare e mjekëve anëtar është 48 vjeç, anëtari më i ri është 23 vjeç, kurse anëtari më i vjetër është 86 vjeç.

Gjatë vitit 2019 për shkak të mos kryerjes së pagesës vjetore të anëtarësisë, janë ç'anëtarësuar 109 mjekë.

4. Mbikëqyrja etiko-profesionale

Për ta pasqyruar ecurinë e mbikëqyrjes etike dhe profesionale pranë organeve të odës, në mënyrë tabelare do të paraqesim ushtrimin e funksionit të tillë nga ana e organeve të odës.

Organi	Numri i lëndëve të pranuar për vitin 2019	Vendimet sipas procedurës së zhvilluar për vitin 2019	Sanksionet e shqiptuara për vitin 2019	Sanksionet e ekzekutuara për vitin 2019	Lëndët në shqyrtim
Prokurori i Odës	36	26	///	///	6
Këshilli Etik	53	32	Gjopa gjithsej 14,000.00 €; Rekomandim kolegjal – 4; Qortime publike – 9; Fshirje nga regjistrimi I anëtarësisë për një vit - 1; Shpenzime paushalle të procedurës – 3,550.00 €;	Gjopa gjithsej 2,100.00 €; Rekomandim Kolegjial - 1 Qortim Publik – 3 Shpenzime të procedurës – 650.00 €	4
Gjyqi i Nderit	6	6	Sipas ankesës është ndryshuar vendimi i Këshillit Etik; Gjobë 6,500.00 €; Rekomandim kolegjal – 2; Qortime Publike – 4; Shpenzime paushalle të procedurës - 1,650.00 €;	Gjobë 1,000.00 €; Rekomandim kolegjal – 2; Qortim Publik – 1; Shpenzime të procedurës - 250.00 €; Deklarata e noterizuar – deponuar nga i sanksionuari	0

Certifikatat e të kalurës etike	117	117	///	///	///
--	-----	-----	-----	-----	-----

Në shqyrtime të drejtpërdrejta, janë mbajtur gjithsej 9 seanca të shqyrtimit kryesor, në të cilin është mundësuar përfaqësimi i drejtpërdrejt i palëve në procedurë, përfshirë të drejtën në përfaqësues me autorizim (prokurë). Ndërkaq në procedurën e mjetit juridik, pranë Gjyqit të Nderit, në seancë të mbyllur janë mbajtur gjithsej 5 mbledhje në të cilat është vendosur për mjetet e parashtruara juridike lidhur me çështjet etiko-profesionale të zhvilluara në shkallë të parë pranë Këshillit Etik.

Vërejtje: Lëndët e pasqyruara në tabelë përfshijnë lëndë që aktualisht ndonjëra prej tyre janë në procedim nga një organ në tjetrin. Për shkak të natyrës së procedurave është pamundur që të nxjerret bilanci i lëndëve në total, për shkak të qarkullueshmërisë së lëndës, varësisht nga faza procedurale në të cilën gjendet lënda e tillë.


5. Edukimi i Vazhdueshëm Profesional

Komisioni për Edukimin e Vazhdueshëm Profesional gjatë vitit 2019, ka akredituar 146 aktivitete.



6. Licencimet

Komisioni për Licencim dhe Rilicencim gjatë vitit 2019, ka lëshuar licenca me kategoritë si në grafikun më poshtë:



Nga data e bartjes së kompetencës për licencim, ky komision i ka lëshuar gjithsej 1756 licenca. Në kriteret e Licencimit/Rilicencimit është edhe ndjekja e programeve për edukim të vazhdueshëm profesional ku mjekët janë të obliguar të fitojnë së paku 20 pikë kredituese në vit, gjegjësisht 100 pikë kredituese për 5 vite.

Komisioni për Licencim i OMK-së bazuar në Rregulloren për Regjistrimin, Licensimin dhe Rilicensimin e mjekëve, saktësisht Nenin 14, paragrafi 1 dhe 2, gjatë vitit 2019 ka shqiptuar gjithsej njëqind e nëntëdhjetë (190) gjoba ndëshkuese për vonesë në anëtarësim prej të cilave:

- a) Nëntë (9) gjoba në vlerë prej gjashtëdhjetë euro (60.00 €)
- b) Njëzet e tre (23) gjoba në vlerë prej nëntëdhjetë euro (90.00 €)
- c) Gjashtëdhjetë e tetë (68) gjoba në vlerë prej njëqind e njëzet euro (120.00 €),
- d) Nëntëdhjetë (90) gjoba në vlerë prej njëqind e pesëdhjetë euro (150.00 €).

7. Edukimi specialistik-zbërthimi i kompetencës bazuar në Ligjin për Shëndetësi dhe Ligjin për OPSH-të

Dizajnimi dhe fillimi i fazës kalimtare të zbërthimit të kompetencave të edukimit specialistik (zbërthimi ligjor, financiar dhe teknik) është në proces e sipër, duke përfshirë edhe hartimin e UA për shkollim specialistik.

8. Komisioni për Çështje Etike i OMK-së

Në vitin 2019, Komisioni për Çështje Etike i OMK-së ka pranuar dhe ka shqyrtuar pesë (5) kërkesa për leje hulumentimi. Të pesë (5) kërkesat e shqyrtuara janë aprovuar nga Komisioni për Çështje Etike dhe aplikantëve i është lëshuar leja për hulumentim.

Gjithashtu Komisioni gjatë kësaj periudhe, përveç vendimeve për leje-hulumtime ka nxjerrë edhe vendimin ku janë miratuar kriteret për leje-hulumtimet bio-mjekësore në njerëz.

9. Komisioni për Solidaritet dhe Ndihmë Reciproke i OMK-së

Në vitin 2019, Komisioni për Solidaritet dhe Ndihmë Reciproke ka pranuar dhjetë (10) kërkesa për përkrahje financiare. Komisioni ka aprovuar tetë kërkesa dhe janë ndarë mjetet financiare për to, kurse për 2 kërkesa ka nxjerrë vendim për refuzim të mbështetjes financiare.

10. Raporti Financiar

10.1 Gjendja financiare – 31 dhjetor 2019

1.0 Të hyrat:				
1.1 Të hyrat e shtyera nga 2018	€143,234.25			
Të hyrat e shtyera nga 2018	€143,234.25			
1.1 Të hyrat	Realizimi: TM1	Realizimi: TM2	Realizimi: TM3	Realizimi: TM4
1.1.1 Të hyrat nga anëtarësia:				
1.1.2 Anëtarësimi i mjekëve shtetas kosovarë	€245,983.88	€62,213.94	€22,175.00	€7,816.00
1.1.3 Anëtarësimi i mjekëve shtetas jo kosovarë	€9,750.00	€4,420.00	€2,500.00	€370.00
1.1.4 Licencimi	€11,377.65	€9,990.00	€10,540.00	€6,740.00
1.1.5 Të hyrat e tjera*	€6,952.20	€23,078.00	€39,531.35	€17,507.20
Të hyrat nga TM	€274,063.73	€99,701.94	€74,746.35	€32,433.20
Të hyrat e shtyera nga 2018				€143,234.25
TOTAL TË HYRAT				€624,179.47

2.0 SHPENZIMET	Shpenzimet: TM1	Shpenzimet: TM2	Shpenzimet: TM3	Shpenzimet: TM4
2.1 Paga dhe kontributet pensionale	€18,199.83	€24,582.83	€24,220.98	€27,064.56
2.2 Mëditjet	€14,260.90	€11,492.94	€8,964.10	€22,075.20
2.3 Material shpenzues për zyrë	€1,335.98	€659.75	€839.57	€1,034.70
2.4 Reprerentacioni	€234.21	€258.80	€332.57	€427.49
2.5 Edukimi i vazhdueshëm profesional	€5,473.25	€8,448.18	€9,910.00	€63,460.45
2.6 Shpenzimet e tjera*	€19,253.70	€20,254.01	€10,131.10	€17,059.37
2.7 Përkrahje financiare në kuadër të fondit për solidaritet	€3,500.00	€0.00	€2,500.00	€3,662.00
TOTAL SHPENZIMET TM:	€62,257.87	€65,696.51	€56,898.32	€134,783.77
TOTAL SHPENZIMET				€319,636.47
TOTAL BILANCI				€304,543.00

1.1.5* Taksë administrative për aplikim për ndrim të kartelës, Regjistrimi në regjistrin e anëtarësisë së OMK-së, Faksimil, Faksimili i dytë, Kongreset, simpoziumet, seminarët, konferenca vendore pa pjesëmarrje ndërkombëtare, aktivitet e organizuara nga kompanitë farmaceutike, Certifikatës për të kaluarën etike, Lejimi për hulumtime bio-mjekësore për anëtarë të Odës, Të hyrat nga dënimet (masat disiplinore), Dhurata / donacione, Të ardhurat të tjera .

2.6 *Faksimil, Anëtarësimi në CPME, Shpenzimet e tel., Shpenzimet e int., Shpenzimet e postës, Paisje të IT, Shpenzime bankare, Shpenzimet e pastrimit, Shpenzimet e transportit, Inventari, Shpenzimet e tjera operative.

10.2 Përkrahje për Edukim të Vazhdueshëm Profesional

Oda e Mjekëve të Kosovës gjatë vitit 2019 ka përkrahur financiarisht 15 aktivitete grupore për Edukim të Vazhdueshëm Profesional, 3 përkrahje individuale të aprovuara në vitin 2018, përkrahje financiare për 5 punimet më të mira si dhe botimin e librit “Enciklopedia e doktorëve të shkencave të mjekësisë shqiptare gjithandej globit (1445-2019) dhe mjekëve që kanë lënë gjurmë të pashlyera në historinë e mjekësisë shqiptare”. Vlera totale e aktiviteteve të përkrahura është 88,191.88 €.

- Për Shoqatën e Nefrologëve të Kosovës në vlerë 1,500.00 €
- Për punëtorinë “Ditët Ndërkombëtare të Menaxhimit të Rrugëve të Frymëmarrjes” në vlerë prej 2,183.25 €
- Për Shoqatën e Dermavenerologëve të Kosovës në vlerë prej 1,000.00 €.
- Për Asociacionin e Psikiaterve të Kosovës në vlerë 1,500.00 €
- Për Shoqatën Kosovare për sigurinë e Pacientit në vlerë prej 1,500.00 €.
- Për Asociacionin Shëndetësor Profesional në vlerë 2,000.00 €
- Për Simpoziumin e parë mbarëshqiptar të Kirurgjisë Pediatrike në vlerë prej 2,698.18 €.
- Për Shoqatën e Onkologëve të Kosovës në vlerë prej 2,000.00 €.
- Për Kongresin e Shoqatës së Ortopedëve të Kosovës në vlerë prej 1,800.00 €.
- Për Kongresin e Shoqatës së sëmundjeve të rralla në bashkëpunim me Klinikën e Pediatrisë në vlerë prej 2,000.00€.
- Për Shërbimin profesional të shëndetit mendor të Kosovës në vlerë prej 1,600.00 €.
- Për Shoqatën e Oftamologëve të Kosovës në vlerë prej 2,000.00€
- Për Shoqatën e Kirurgëve Plastik të Kosovës Trajnim i stafit mjekësor me metoda bazike dhe bashkekohore për trajnimin e djegjeve, në vlerë prej 2,000.00 €.
- Për Konferencën e parë të Neonatologëve të Kosovës në vlerë prej 2.000.00 €.
- Për Konferencën e pestë të Kirurgëve të Përgjithshëm të Kosovës në vlerë prej 2.000.00€.
- Organizimi i Kongresi dhe Panairi i Parë Mjekësor në vlerë 43,747.95 €
- Përkrahje në botimin e librit “Enciklopedia e doktorëve të shkencave të mjekësisë shqiptare gjithandej globit (1445-2019) dhe mjekëve që kanë lënë gjurmë të pashlyera në historinë e mjekësisë shqiptare” në vlerë 2,600.00 €
- Përkrahje për pesë punimet shkencore më të mira të publikuara përgjatë vitit 2018 dhe 2019 me vlerë 15,000.00 €

10.3 Prokurimi

Gjatë vitit 2019 u zhvilluan shtatë procedura të prokurimit:


- Dy procedura të hapura të prokurimit për auditim funksional dhe financiar të OMK-së për vitin 2018, janë anuluar për shkak të mungesës së aplikimeve. Shpallja e tenderit herën e tretë me procedurë të negociuar të prokurimit është përzgjedhur Operatori Ekonomik “Audit & Conto” NSH.
- Aktiviteti i prokurimit për furnizimin me orendi të zyrave të OMK-së u zhvillua në mënyrë të rregullt, ku operatori ekonomik shërbimet i ka kryer sipas kushteve të parapara në dosje të tenderit dhe në kontratë.
- Në muajin qershor bazuar në ofertat të pranuar, është bërë furnizimi i zyrave të OMK-së me pajisje kondicioner.
- Gjatë tremujorit të tretë të vitit 2019, u zhvillua procedura njëburimore e prokurimit sipas Vendimit nga Këshilli Drejtues për vendin e mbajtjes së Kongresit dhe Panairit të Parë Mjekësorë - "Hotel Emerald", si dhe procedura e hapur e prokurimit për ndërtimin e stendave për Kongresin dhe Panairin e Parë Mjekësor.
- Në muajin gusht bazuar në ofertat të pranuar, është bërë marrëveshja me operatorin ekonomik “Kutia” për ridizajnim të ueb faqes dhe hapjes të nënfaqes për Kongres.
- Gjatë tremujorit të katërt të 2019 u zhvillua procedura e hapur e prokurimit për Auditim Funksional dhe Financiar për 3 vitet e ardhshme, ku është përzgjedhur operatori ekonomik me vlerë totale të kontratës 7,200.00 €.

11. Aktivitete të tjera

11.1 Shërbimi profesional

Pas aprovimit të organogramit nga Këshilli Drejtues, gjatë vitit 2019 sipas konkursit të hapur janë përzgjedhur 4 Asistent administrativ dhe një Zyrtar për Financa dhe Marketing. Në tabelën më poshtë është ilustruar organogrami i Odës së Mjekëve të Kosovës:

Struktura Organizative e Shërbimit Profesional të OMK-së



11.2 Kongresi dhe Panairi i Parë i Mjekësisë

Me datë 17 tetor u bë hapja solemne e Kongresit dhe Panairit të Parë Mjekësor, ku të pranishëm ishin mysafir të ftuar, ish ministra të shëndetësisë, ligjerues ndërkombëtar si dhe Sekretarja e Përgjithshme e CPME Znj. Annabel Seebom, e cila ju drejtua të pranishmëve me një fjalë rasti. Ndër aktivitetet kryesore ishte edhe promovimi i librit të Prof. Dr. Isuf Dedushaj me titull “Enciklopedi e doktorëve të shkencave të mjekësisë shqiptare gjithandej globit (1445 – 2018) dhe mjekëve që lanë gjurmë të pashlyera në historinë e mjekësisë shqiptare”. Profesionistët më të dalluar të fushës së mjekësisë pranuan dekoratën Nderi i mjekut “Ali Sokoli” dhe “Musa Haxhiu”, për kontributin e veçantë të dhënë në themelimin dhe zhvillimin e shërbimeve dhe institucioneve shëndetësore në Kosovë.

Me qëllim të promovimit të shkencës kosovare, përkrahjen e zhvillimit të kapaciteteve njerëzore shkencore të vendit u shpërblyen pesë punimet shkencore më të mira të publikuara përgjatë vitit 2018 dhe 2019

Gjatë dy ditëve të Kongresit morrën pjesë mbi 2000 mjekë, specialistë të fushave të ndryshme. Ata patën rastin të ndjekin punimet shkencore nga ligjërues vendor dhe të huaj. Përveç ligjëratave gjatë kongresit gjithashtu paralelisht u zhvilluan katër punëtori nga ekspertë të fushave përkatëse me temat:

- Menaxhimi i avancuar i rrugëve ajrore/Menaxhimi i rrugëve ajrore në Trauma
- Diagnostika e avancuar në pacemaker dhe ICD
- Këshillimi virtual për kontraceptiv
- Uveitet,

ku pjesëmarrësit u njoftuan me metodat dhe teknologjitë më të reja mjekësore.

Në bashkëpunim me Qendrën e Telemjekësisë së Kosovës të gjitha punimet janë transmetuar në kohë reale, ku mjekë dhe qytetarë kanë mundur të përcjellin ligjëratat në web faqe të odës, në kanalin e youtube të Qendrës së Telemjekësisë si dhe në të gjitha spitalet rajonale të Kosovës.

Përgjatë programit edukativ, u zhvillua me shumë sukses edhe Panairi i Mjekësisë, ku kompanive dhe organizatave të ndryshme iu dha mundësia të ekspozojnë produktet, shërbimet dhe aktivitetet e tyre për të interesuarit në Kongres.

11.3 Punëtorja “Ditët ndërkombëtare të menaxhimit të rrugëve të frymëmarrjes”

Më 2 mars 2019 Oda e Mjekëve të Kosovës në bashkorganizim me Shoqatën Kosovare për Menaxhimin e Rrugëve të Frymëmarrjes mbajtën punëtorinë “Ditët Ndërkombëtare të Menaxhimit të Rrugëve të Frymëmarrjes”. Punëtorja e ndarë në dy sesione, në të cilat ligjeruan 8 ekspertë ndërkombëtarë dhe 13 vendor, kurse në sesionin e dytë profesionistët shëndetësorë janë ndarë në 8 grupe për të qenë pjesë e anës praktike të punëtorisë Menaxhimi i Avansuar i Rrugëve të Frymëmarrjes të Trauma.

11.4 Simpoziumi i parë Mbarëshqiptar i Kirurgjisë Pediatrike

Më 19 prill 2019, nën patronazhin e Odës së Mjekëve të Kosovës dhe në bashkëorganizim me Klinikën e Kirurgjisë Pediatrike është mbajtur Simpoziumi i Parë mbarëshqiptar i Kirurgjisë Pediatrike.

11.5 Marrëveshjet

Gjatë vitit 2019 në kuadër të ofertave lehtësuese për anëtarët janë lidhur tre marrëveshje bashkëpunimi, si dhe katër marrëveshje me qëllim të rritjes dhe përmirësimit të standardeve dhe cilësisë së shërbimit dhe kujdesit shëndetësor.

- ***Marrëveshje mirëkuptimi me kompaninë e sigurimeve “Scardian” J.S.C***

Në muajin mars është lidhur marrëveshje mirëkuptimi me kompaninë e sigurimeve “Scardian” J.S.C. me qëllim të sigurimit të ofertave të veçanta në kuptim të kushteve dhe çmimit për të gjithë anëtarët e saj.

- ***Marrëveshje bashkëpunimi me Auto Shtëpia Siqani***

Marrëveshjeve të bashkëpunimit/mirëkuptimit është lidhur me kompaninë “Auto Shtëpia Siqani” që ofron zbritje deri në 10 % në blerjen e veturave të reja për të gjithë mjekët e anëtarësuar në Odë,

- ***Marrëveshje bashkëpunimi me Sigal UNIQA Group Austria***

Në muajin Qershor është nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me Kompaninë e Sigurimeve Sigal UNIQA Group Austria. Kjo marrëveshje synon komunikim në mes subjekteve të marrëveshjes lidhur me ofrimin e sigurimit të përgjegjësisë profesionale për mjekët/anëtarë të OMK-së nga kompania e sigurimeve. Oferta është dizajnuar për përgjegjësinë profesionale të mjekëve gjatë ushtrimit të profesionit të tyre të cilët mund të atakohen me rreziqe të ndryshme, ndër më të rëndësishmit ato të gabimeve të mundshme profesionale, ku këto gabime mund ti bëjnë përgjegjës ligjërisht ndaj palëve të treta.

- ***Marrëveshje bashkëpunimi me Inspektoratin Shëndetësor***

Në muajin prill 2019, është nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi në mes të Odës së Mjekëve të Kosovës dhe Inspektoratit Shëndetësor të Ministrisë së Shëndetësisë. Qëllimi i kësaj marrëveshje është zyrtarizimi i bashkëpunimit të ndërsjellë institucional për të siguruar një mbikëqyrje dhe zbatim të legjislacionit në fuqi,

sigurimin e integritetit profesional të mjekut si profesionist shëndetësor, forcimin institucional të sistemit shëndetësor në interes të përgjithshëm të qytetarëve të Republikës së Kosovës duke mbrojtur kështu edhe interesat e pacientëve që janë përfitues të shërbimeve shëndetësore.

- ***Marrëveshje bashkëpunimi me Odën e Stomatologëve të Kosovës***

Në muajin maj është lidhur marrëveshje bashkëpunimi me Odën e Stomatologëve të Kosovës, duke e konsideruar të domosdoshëm këtë bashkëpunim për rritjen dhe përmirësimin e standardeve dhe cilësisë së kujdesit shëndetësor.

Odat u dakorduan për t'i njohur disa nga format e ndryshme të organizimit të Edukimit të Vazhdueshëm Profesional në mënyrë reciproke me anë të akreditimit

- ***Marrëveshje bashkëpunimi me Shoqatën e Grave “Medica Gjakova”***

Në muajin gusht lidhur marrëveshje bashkëpunimi me Shoqatën e Grave “Medica Gjakova” me qëllim të implementimit e projektit “Përmirësimi i shërbimeve dhe kujdesit shëndetësor ndaj traumave për gra dhe vajza të mbijetuara të dhunës në baza gjinore dhe të dhunës seksuale” i cili synon forcimin e kapaciteteve të ofruesve të shërbimeve shëndetësore publike për gra dhe vajza të mbijetuara të dhunës në baza gjinore dhe të dhunës seksuale dhe implementohet në dy komuna në atë të Gjakovës dhe Prizrenit.

- ***Marrëveshje mes Odave të Profesionistëve Shëndetësor për ndërtimin e objektit të përbashkët***

Në muajin gusht 2019, Odat e profesionistëve shëndetësor në Kosovë kanë nënshkruar marrëveshje të përbashkët, mbi zbatimin e projektit për ndërtimin e objektit, për nevojat e ushtrimit të veprimtarisë dhe funksioneve publike të përcaktuara me ligj. Ndërtimi i objektit pritet të përkrahët nga Agjencia për Bashkëpunim e Luksemburgut përmes projektit “Health Support Programme in Kosovo Phase II-KSV/017”, si dhe me mbështetje financiare nga të gjitha Odat.

11.6 Faksimilët

Të gjithë anëtarët e OMK-së të kualifikuar për t'u pajisur me faksimil (anëtarë me licencë valide) janë pajisur me faksimile të cilat i ka shpërndarë oda.

Numri total i faksimilave të shpërndara është 4691 (ku përfshihen faksimili i parë, faksimili i dytë, faksimilat të cilave ju ka ndryshuar statusi p.sh nga Doktor i

Mjekësisë në Specilist ose Sub-Specialist, faksmilat e humbur si dhe faksmilat me gabime)

Me datë 1 maj 2019, ka hyrë në fuqi Vendimi për përdorimin Obligativ të faksmileve të autorizuara dhe validuara nga OMK për të gjithë anëtarët e Odës. Sipas vendimit, çdo përdorim i faksmileve tjera të prodhuara apo punuara individualisht dhe të përdorura nga anëtarët e OMK-së apo mjekë ende të pa anëtarësuar, është në kundërshtim me këtë vendim, në kundërshtim me aktet tjera juridike të OMK-së, si dhe është vepër penale sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës. Bazuar në këtë vendim, dy raste janë në procedurë të Këshilli Etik të OMK-së, të cilat janë në procedurë tek organet shtetërore të hetuesisë.

11.7 Bashkëpunimi profesional dhe veprimtaria ekspertike

Në kuadër të kompetencës publike lidhur me mbikëqyrjen e veprimtarisë profesionale dhe në kuadër të bashkëpunimit ndërinstitucional lidhur me veprimtarin profesionale të mjekëve, Kryetari i OMK-së duke u bazuar në kompetencat ligjore sipas Ligjit për OPSH-të, në bazë të kërkesave nga Gjykatat dhe prokurorit publike të Kosovës, ka caktuar ekspert apo grupe të ekspertëve lidhur me konstatimin e përgjegjësisë profesionale mbi zbatimin e procedurave mjekësore nga mjekët gjegjës. Ekspertiza të tilla kanë qenë në shërbim të konstatimit të përgjegjësisë individuale të mjekëve të cilët i janë nënshtruar procedurave penale apo civile, qoftë në fazën hetimore apo gjatë shqyrtimeve gjyqësore

Ekspertizat:

Organi	Numri i lëndëve të pranuar për vitin 2019	Vendimet sipas urdhërësive së pranuar për vitin 2019	Në procedurë	Raportet e ekspertizave të përfunduara për vitin 2019
Kryetari i Odës	10	11	5	5

11.8 Punëtori për Sistemin e informimit të OMK-së

Gjatë muajit shtator dhe nëntor, stafi profesional i Odës dhe dy ekspertë të IT-së morrën pjesë në punëtorinë për “Definimin e procesit të punës me qëllim të digjitalizimit/automatizimit të proceseve kyçe dhe shërbimeve të OMK-së”, ku si përfundim u identifikuan të gjitha proceset e punës dhe specifikacionet në bazë të të cilave do të shpallet tenderi për databazë nga projekti KSV/017.

11.9 Auditimi financiar dhe funksional

Me datë 14 gusht 2019 ka përfunduar auditimi i pasqyrave financiare për vitin 2018. Auditimi financiar dhe funksional përfshinë Raportin e auditorëve të pavarur, Pasqyrat e të ardhurave gjithëpërfshirëse, Pasqyra e pozitës financiare, Pasqyra e ndryshimeve në fonde, Pasqyra e rrjedhës së parasë dhe shënimet e pasqyrave financiare. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit.

Raporti i auditimit si dhe rekomandimet e dala nga ky auditim janë aprovuar nga Këshilli Drejtues i OMK-së.

Raporti i auditimit është i publikuar në ueb faqen e OMK-së.

11.10 Marrëdhënie ndërkombëtare

Në kuadër të marrëdhënieve ndërkombëtare Oda e Mjekëve të Kosovës ka marr pjesë në këto takime:

- Asamblenë e Përgjithshme e Komitetit të Përhershëm të Mjekëve European (CPME). Gazeta zyrtare e Komitetit të Përhershëm të Mjekëve European në edicionin e 29-të të botuar në Qershor 2019 i ka dedikuar artikull OMK-së si storje suksesi.
- Simpoziumi i 26-të i ZEVA-s
- Takimi i Forumit Evropian të shoqatave mjekësore (EFMA)
- Kongresi i 122-të të Odës së Mjekëve të Gjermanisë

12. Plani i veprimit për 2020

Projektet afatmesme dhe afatgjata

- Projekti për ndërtimin e një objekti për të gjitha OPSH-të, mbështetur nga MSH-ja, financuar nga Projekti KSV/017 “Përkrahja për Sektorin e Shëndetësisë”. Kësaj iniciative i janë përgjigjur të gjitha OPSH-të dhe kërkesa zyrtare për mbështetje është nënshkruar nga të gjitha ato, dhe më pas është dorëzuar në MSH. Fillimi i ndërtimit pritet të fillon pas miratimit të marrëveshjes për vazhdimin e projektit të KSV/017 nga Kuvendi i Kosovës.
- Pas miratimit të kërkesës nga OMK drejtuar LuxDev-it lidhur me përkrahje financiare për zhvillimin e sistemit informativ/databazë interaktive, ku do të përfshihen të gjitha proceset e OMK-së. Kohëzgjatja e projektit – 1 vit.
- Zbërthimi dhe bartja e kompetencave për edukimin specialistik bazuar në Ligjin për Shëndetësi dhe Ligjin për OPSH-të.
- Organizimi i Kongresit vjetor i fokusuar në lëminë e Onkologjisë.